


Fuqizimi i kapaciteteve të komunave për angazhimin e diasporës në Kosovë



Shkurt 2026



Implemented by



Fuqizimi i kapaciteteve të
komunave për angazhimin e
diasporës në Kosovë
Raport i vlerësimit të nevojave

Shkurt 2026

Deklaratë mohimi:

Ky raport është zhvilluar nga Instituti
GAP me mbështetjen e Deutsche
Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.
Përmbajtja është përgjegjësi e vetme
e Institutit GAP dhe nuk pasqyron
domosdoshmërisht qëndrimet e
Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

*Ky raport është shkruar fillimisht në
gjuhën angleze.*

— **Përmbajtja**

Lista e shkurtesave	3
Përmbledhje ekzekutive	4
1. Hyrje	5
2. Metodologjia	5
3. Shqyrtimi i kornizave institucionale, ligjore dhe politike	6
3.1. Korniza ligjore	6
3.2. Mekanizmat institucionalë në nivel lokal për angazhimin e diasporës	7
4. Konsultimet me palët e interesit dhe analiza e gjetjeve	8
4.1. Kapacitetet dhe strukturat komunale për angazhimin e diasporës	8
4.2. Ofrimi i shërbimeve	9
4.3. Shkëmbimi arsimor dhe kulturor	10
4.4. Potenciali ekonomik	11
4.5. Sfidat e koordinimit mes institucioneve lokale dhe qendrore	11
5. Hartëzimi digjital	13
5.1. Kanalet e komunikimit të komunave	14
6. Përfundimi dhe rekomandimet	15
Aneksi	16

Lista e shkurtesave

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
BMZ	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
B2B	Biznes me Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DZhED	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
IHD	Investime të Huaja Direkte
KIESA	Agjencia e Kosovës për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile

Përmbledhje ekzekutive

Angazhimi i diasporës mbetet një prioritet i rëndësishëm shoqëror, ekonomik dhe politik për Kosovën, duke pasur parasysh pjesën e madhe të popullsisë që jeton jashtë vendit. Ky raport paraqet një vlerësim të plotë të shërbimeve që lidhen me diasporën në nivel komunal në Kosovë, me synimin për të identifikuar ndërhyrje praktike që mund të përmirësojnë angazhimin lokal, ofrimin e shërbimeve dhe koordinimin me komunitetet e diasporës. Gjetjet e këtij raporti theksojnë sfidat strukturore dhe institucionale që vazhdojnë të kufizojnë shfrytëzimin e potencialit të madh të diasporës së Kosovës në zhvillimin lokal. Pavarësisht rëndësisë strategjike të diasporës, Kosova nuk ka një kornizë ligjore detyruese që siguron mbështetje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar mirë për angazhimin e diasporës në nivel komunal. Si rezultat, shërbimet që u ofrohen anëtarëve të diasporës ndryshojnë dukshëm mes komunave, duke filluar nga drejtoritë e dedikuara dhe zyrtarët me kohë të plotë për diasporën, deri tek mbështetja minimale ose me karakter të rastësishëm.

Shërbimet administrative mbeten forma më e zakonshme e angazhimit të diasporës me nivelin lokal, të fokusuara kryesisht në dokumentacionin civil dhe regjistrimin e pronës. Disa komuna kanë ndërmarrë hapa për të përmirësuar cilësinë dhe qasjen në këto shërbime, veçanërisht gjatë periudhave të vizitave të mëdha të diasporës, por angazhimi më i gjerë ekonomik dhe kulturor mbetet i kufizuar. Qasje inovative po shfaqen në komuna si Kamenica, Gjilani dhe Vushtrria, ku iniciativat përfshijnë këshillime të përshtatura për investime, partneritete mes sektorit publik dhe privat, dhe platforma digjitale për të monitoruar bizneset lokale dhe për t'u lidhur me investitorët nga diaspora.

Në këtë raport, Instituti GAP thekson edhe boshllëqet në koordinim mes institucioneve lokale dhe qendrore. Mungesa e komunikimit të strukturuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, MPJD, ka sjellë përsëritje të aktiviteteve, pasiguri në politika dhe qasje të kufizuar në programet kombëtare. Për më tepër, komunat shpesh nuk kanë burimet dhe qartësinë ligjore të nevojshme për të krijuar pozita të reja që lidhen me diasporën ose për të integruar çështjet e diasporës në planifikimin afatgjatë.

Ky raport paraqet ndërhyrje plotësuese që synojnë forcimin e angazhimit komunal me komunitetet e diasporës. Emërimi i zyrtarëve me kohë të plotë për diasporën do të siguronte vazhdimësi institucionale dhe do t'u mundësonte komunave të koordinojnë më mirë mundësitë për investime, shkëmbime kulturore dhe partneritete. Financimi i synuar publik për organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset lokale do të mbështeste nisma në nivel lokal dhe do të krijonte lidhje më të qëndrueshme me diasporën. Për më tepër, përmirësimi i infrastrukturës digjitale, përmes uebfaqeve të integruara komunale dhe kanaleve aktive në rrjete sociale, do të lehtësonte komunikimin më të qashtë dhe më të përgjegjshëm me anëtarët e diasporës. Së fundi, integrimi i një qasjeje të ndjeshme ndaj barazisë gjinore do të siguronte që nevojat dhe kontributet e grave të diasporës të njihen dhe të mbështeten përmes programeve gjithëpërfshirëse dhe politikave të bazuara në të dhëna.

1. Hyrje

Kosova konsiderohet të ketë një nga komunitetet më të mëdha të diasporës në Evropë në raport me popullsinë brenda vendit.¹ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rreth 338,000 persona, apo afërsisht 19 për qind e popullsisë, kanë emigruar ndërmjet viteve 2012 dhe 2022, ndërsa vetëm rreth 91,800 janë kthyer gjatë së njëjtës periudhë.² Pika më e lartë ka qenë në vitin 2015, kur më shumë se 74,000 persona janë larguar dhe gati 19,000 janë kthyer, duke rezultuar në humbjen më të madhe vjetore prej rreth 55,500 personash.³ Ky trend tregon rritjen e diasporës dhe nënvizon nevojën për politika më të strukturuar si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel lokal.

Dërgesat financiare nga diaspora kontribuojnë dukshëm në BPV të Kosovës, duke përbërë rreth 12 për qind çdo vit. Këto dërgesa historikisht kanë ofruar një mbështetje të rëndësishme gjatë periudhave të krizës, si periudha e pasluftës, pasiguria financiare dhe pandemia COVID 19. Përveç dërgesave, diaspora kontribuon në Kosovë përmes investimeve, filantropisë, shkëmbimit të njohurive, avokimit politik dhe nismave të zhvillimit shoqëror. Megjithatë, korniza ligjore që rregullon statusin dhe të drejtat e diasporës mbetet e vjetruar, duke krijuar pasiguri në njohjen institucionale dhe trajtimin e diasporës së Kosovës.

Komunat gëzojnë një shkallë autonomie sipas politikave të decentralizimit në Kosovë, gjë që u mundëson atyre të mbështesin shërbimet që lidhen me diasporën dhe nismat investuese. Në praktikë, megjithatë, zbatimi i këtyre kompetencave ndryshon shumë nga një komunë në tjetrën.

2. Metodologjia

Ky raport synon të analizojë strukturat aktuale komunale në lidhje me nivelin, llojin dhe cilësinë e shërbimeve që u ofrohen anëtarëve të diasporës së Kosovës. Përveç kësaj, raporti synon të japë një pasqyrë të qartë të gjendjes aktuale dhe të paraqesë hapat që duhet të ndërmerren për të avancuar më tej këto shërbime dhe strukturën e tyre institucionale.

Për ta arritur këtë, vlerësimi është mbështetur në një kombinim të burimeve të të dhënave primare dhe sekondare, duke integruar metoda cilësore dhe sasiore për të siguruar një analizë të plotë. Të dhënat primare janë mbledhur përmes tetë intervistave të shkurtra, gjysmë të strukturuar, me akterë kyç, përfshirë përfaqësues nga institucione dhe organizata të përfshira në punën që lidhet me diasporën, Aneksi 2. Përzgjedhja e komunave për intervistat është bërë për të siguruar një përfaqësim të balancuar të strukturave të qeverisjes lokale në Kosovë. Ajo ka përfshirë tri komuna më të mëdha për nga popullsia, Prizrenin, Ferizajn dhe Gjiçanin, tri komuna të mesme-të vogla, Vushtrrinë, Suharekën dhe Lipjanin, dhe dy komuna më të vogla, Kamenicën dhe Dragashin, secila nga zona të ndryshme gjeografike.

Për më tepër, është zhvilluar një grup i fokusuar me zyrtarë publikë që përfaqësonin 13 komuna në gjithë Kosovën, përfaqësues nga MPJD dhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat pjesëmarrëse në këtë diskutim të grupit të fokusuar, së bashku me MPJD dhe AKK, kanë përfshirë Drenasin, Obiliqin, Gjakovën, Pejën, Gjiçanin, Prishtinën, Kaçanikun, Suharekën, Klinën, Lipjanin, Prizrenin, Mamushën dhe Ferizajn. Qëllimi ka qenë të mblidhen perspektiva të ndryshme mbi angazhimin e diasporës në nivel lokal. Përbërja e grupit të fokusuar

¹ Golloperi. B. Kosovar Emigration: Causes, Losses and Benefits , 2016.

² Agjencia e Statistikave të Kosovës, [Popullsia e Kosovës 2022](#)

³ Ibid.

ka përfshirë katër gra dhe 18 burra, duke reflektuar vëmendje ndaj përfaqësimit gjinor në institucionet lokale. Kjo pasqyron problemet më të gjera të nën përfaqësimit të grave në qeverisjen lokale. Nga 6,103 të punësuar në komuna, gratë përbëjnë vetëm 33 për qind (2022) të numrit të përgjithshëm.⁴ Përveç grupit të fokusuar, mbledhja e të dhënave primare ka synuar edhe përfshirjen e një pyetësi online të shpërndarë në të gjitha komunat, megjithatë, vetëm tri komuna janë përgjigjur.⁵ Më tej, janë zhvilluar intervista edhe me dy organizata që specializohen në angazhimin e diasporës dhe një organizatë që fokusohet në integrimin e perspektivës gjinore, me qëllim analizimin e pikëpamjes së shoqërisë civile për këtë temë.

Të dhënat sekondare janë mbledhur përmes një shqyrtimi të gjerë të kornizës institucionale, ligjore dhe politike që udhëzon angazhimin e diasporës në nivel lokal. Kjo është plotësuar me kërkime në dokumente dhe një rishikim të literaturës me synimin për të identifikuar praktikatat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare.

3. Shqyrtimi i kornizave institucionale, ligjore dhe politike

3.1. Korniza ligjore

Megjithëse Kosova e ka miratuar Ligjin për Diasporën dhe Migrimin në vitin 2012⁶, hartimi i një ligji të ri konsiderohet i domosdoshëm për shkak të mangësive ligjore, institucionale dhe praktike që janë bërë gjithnjë e më të dukshme gjatë dekadës së fundit, sipas palëve të intervistuar. Ligji i vitit 2012 tani shihet gjerësisht si i vjetruar dhe me fokus të ngushtë, duke i dhënë përparësi identitetit kulturor dhe dërgesave financiare, në përputhje me shqetësimet pas pavarësisë, por pa reflektuar zhvillimet e fundit në angazhimin e diasporës, si diplomacia digjitale, shtetësia e dyfishtë, shkëmbimi i njohurive dhe përfshirja politike.⁷ Për më tepër, ligji zbatohet dobët, me shumë prej dispozitave të tij që mbeten të pazbatuara për shkak të mungesës së llogaridhënies institucionale, financimit dhe mbikëqyrjes. Ndarja e paqartë e përgjegjësisë mes disa ministrive dhe komunave ka çuar në fragmentim dhe efikasitet të ulët. Kjo përfshin detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve të diasporës, si dhe mekanizmin e mbikëqyrjes.

Një projektligj është prezantuar në vitin 2018⁸ dhe ka kaluar shqyrtimin e parë në Kuvend në vitin 2019, por nuk është votuar ndonjëherë në formë përfundimtare. Në vitin 2025, Ligji për Diasporën mbetet në formë projektligji dhe është përfshirë në agjendën legjislative të qeverisë me synimin për miratim deri në dhjetor 2026.⁹ Kosova nuk e ka miratuar ende projektligjin e ri për diasporën dhe as ndonjë strategji kombëtare të detyrueshme për angazhimin e diasporës. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), përmes Departamentit të Diasporës, ka hartuar disa versione të strategjisë kombëtare për diasporën, veçanërisht draftin për periudhën 2021 deri 2025, por kjo strategji nuk është miratuar nga Qeveria apo Kuvendi i Kosovës.

Projektligji parasheh disa reforma strukturore, përfshirë themelimin e koordinatorëve komunalë për diasporën, krijimin e regjistrave të diasporës dhe nxitjen e partneriteteve institucionale mes qeverisjes lokale dhe shoqatave të

⁴ Instituti GAP. [Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë, 2020](#).

⁵ Për shkak të mungesës së zërtarëve që merren plotësisht me angazhimin e diasporës, u shpërndanë vetëm tre pyetësorë.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 04/L – 095 për diasporën dhe migratën](#), 2022.

⁷ Shënime nga intervistat.

⁸ Platforma e Konsultimeve Publike. [Projektligji për diasporën](#).

⁹ Zyra e Kryeministrit. [Programi i Projektligjeve të Qeverisë për vitin 2025–2027](#)

diasporës.¹⁰ Këto dispozita pasqyrojnë një vizion më koherent për mënyrën se si angazhimi i diasporës mund të integrohet në kuadrin e qeverisjes lokale.

Megjithatë, mungesa e miratimit formal të projektligjit të ri ose strategjisë i ka bërë këto nisma të pa detyrueshme dhe, rrjedhimisht, jo funksionale. Pa miratimin e ligjit nga Kuvendi ose pa aprovimin qeveritar të strategjisë, komunat nuk kanë detyrim ligjor për t'i zbatuar këto propozime. Kjo situatë ka kufizuar ndikimin praktik të reformave dhe ka kontribuar në mungesën e vazhdueshme të uniformitetit në ofrimin e shërbimeve nëpër komuna.

Të njëjtat kufizime zbatohen edhe për projekt strategjinë kombëtare për diasporën 2021 deri 2025, bazuar në projektligjin e ri, e cila edhe pse është shpërndarë mes institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, mbetet një dokument jo ekzekutiv. Disa nga objektivat e saj janë ndjekur përmes nismave pilot ose projekteve të mbështetura nga donatorët, por në mungesë të miratimit formal, strategjia nuk ka fuqi ligjore dhe nuk mund të integrohet në planet e zhvillimit komunal ose në proceset e buxhetimit. Si rezultat, zbatimi i saj mbetet i pabarabartë dhe kryesisht simbolik.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale u jep komunave autoritet për të vendosur bashkëpunime dhe partneritete ndërkombëtare, neni 17, por nuk u cakton komunave përgjegjësi të qarta për angazhimin e diasporës.¹¹ Kjo ka sjellë paqartësi në interpretim për ndarjen e kompetencave mes institucioneve qendrore dhe lokale.

— 3.2. Mekanizmat institucionalë në nivel lokal për angazhimin e diasporës

Angazhimi komunal me komunitetet e diasporës në Kosovë mbetet i pabarabartë dhe varet kryesisht nga diskrecioni, kapaciteti dhe iniciativa e vetë komunave. Mungesa e një kornize të qartë ligjore luan rol qendror në këtë mospërputhje. Autoritetet komunale nuk kanë detyrim ligjor të ofrojnë shërbime të përshtatura për diasporën, si asistencë për dokumentacionin e pronës, lehtësim të votimit jashtë vendit, programe kulturore ose mbështetje për investimet e udhëhequra nga diaspora, e po ashtu nuk ekziston një strategji kombëtare që përcakton përgjegjësitë komunale. Kjo paqartësi ligjore kufizon aftësinë e komunave për të ndarë burime për aktivitete që lidhen me diasporën, duke i lënë ato të mbështeten në financime afatshkurtra nga donatorët, nisma të brendshme me karakter të rastësishëm ose buxhetim diskrecional. Ajo ndikon edhe në koordinimin e dobët institucional mes autoriteteve qendrore, veçanërisht Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) dhe qeverisjes lokale. Nuk ekziston një mekanizëm formal për koordinim vertikal ose për ndarje të të dhënave, gjë që çon në përsëritje të aktiviteteve, qasje të fragmentuar dhe mospërputhje në politika.

Brenda këtij kuadri të paqartë, komunat kanë miratuar një sërë organizimesh institucionale. Disa kanë krijuar struktura formale, si drejtori për diasporën, sektorë ose zyra të dedikuara, ndërsa të tjerat kanë ngritur njësi më të vogla ose nuk kanë fare infrastrukturë që lidhet me diasporën. Vushtrria dallohet me një Drejtori funksionale të Diasporës, ndërsa Suhareka, që më parë kishte një drejtori të tillë, tani operon me një sektor më të vogël. Në raste të tjera, përgjegjësitë për diasporën janë të integruara në portofola më të gjera. Për detyrat që lidhen me diasporën, Kamenica angazhon një zyrtar/e përmes kontratave të shërbimit (e cila duhet të rinovohet çdo 6 muaj dhe i njëjti person mund të mos e marrë

¹⁰ Platforma e Konsultimeve Publike. [Projektligji për diasporën](#)

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale](#).

këtë pozitë), ndërsa Vushtrria angazhon një zyrtar/e për diasporën si zgjidhje të përkohshme për stafin që punon në integritet evropiane. Zhvillimet e fundit tregojnë përpjekje në rritje drejt institucionalizimit, për shembull, Gjilani dhe Podujeva kanë hapur pozita zyrtare për Koordinator/e për Investime të Diasporës, pozitë që është përfshirë në Katalogun e Punëve të Shërbimit Civil të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Përtej strukturave institucionale, komunat ndryshojnë edhe në gamën dhe cilësinë e shërbimeve. Disa komuna, përfshirë Vushtrrinë, Kamenicën, Gjilani, Suharekën, Prizrenin, Lipjanin dhe Ferizajn, mirëmbajnë baza të dhënash për bizneset në pronësi të diasporës ose zgjerojnë orarin e shërbimeve dhe hapin sportele shtesë gjatë periudhave të kthimit masiv në verë. Gjilani ka prezantuar regjistrimin e pronës me procedurë të përshtetshme dhe orar të zgjatur të punës për të përmbushur më mirë nevojat e diasporës, ndërsa komuna si Vushtrria dhe Kamenica kanë zbatuar mekanizma aktivë të informimit për ta mbajtur diasporën të azhurnuar për zhvillimet lokale. Shumë komuna kanë emëruar koordinatore për diasporën ose këshilla këshillëdhënëse që merren me angazhimin e diasporës në planifikimin komunal, identifikimin e mundësive të investimit, organizimin e vizitave dhe forumeve, si dhe bashkëpunimin me ambasadat dhe konsullatat.

Përfitimet e strukturave të qarta të brendshme dhe të roleve të përcaktuara shihen më qartë në Vushtrri, ku zyra e dedikuar për diasporën ka lehtësuar marrëveshje binjakezimi me komuna evropiane, ka mbështetur programe të shkëmbimit profesional dhe ka tërhequr investime direkte nga bizneset e diasporës. Aftësia e komunës për të mirëmbajtur baza të dhënash të plotë, për të bashkëpunuar më mirë me institucionet qendrore, për të aplikuar për fonde të jashtme dhe për të koordinuar aktivitete B2B tregon se si angazhimi institucional mund ta shndërrojë angazhimin e diasporës në një shtytës të zhvillimit ekonomik dhe social lokal.

4. Konsultimet me palët e interesit dhe analiza e gjetjeve

4.1. Kapacitetet dhe strukturat komunale për angazhimin e diasporës

Nga perspektiva administrative, shumica e komunave në Kosovë, veçanërisht ato më të voglat, përballen me mungesë të stafit.¹² Ky problem është veçanërisht i dukshëm në menaxhimin e çështjeve që lidhen me diasporën. Përgjegjësitë për diasporën shpesh u shtohen detyrave të tjera të stafit komunal që punon me kohë të plotë, gjë që çon në angazhim të fragmentuar dhe të paqëndrueshëm. Megjithatë, ka përjashtime si Suhareka, Vushtrria dhe Kamenica, të cilat e kanë institucionalizuar angazhimin e tyre për diasporën përmes drejtorive ose sektorëve të dedikuar, duke krijuar një pikë kontakti më të qëndrueshme dhe më të dukshme për komunitetet e diasporës. Kamenica ka ndërmarrë edhe hapa proaktivë duke emëruar një koordinator me kohë të plotë, përgjegjës për turizmin dhe diasporën, duke e integruar këtë rol në strategjinë e zhvillimit të komunës.

Në përgjithësi, kufizimet buxhetore dhe ligjore të vendosura nga Ministria e Financave e kanë vështirësuar krijimin e pozitave të reja me linja të veçanta buxhetore.¹³ Si rezultat, zyrtarët për diasporën, aty ku ekzistojnë, shpesh punësohen me orar të pjesshëm, pa përgjegjësi të qarta. Ndërsa Podujeva dhe

¹² Një deklaratë e përmendur nga shumë komuna më të vogla gjatë intervistave të thelluara.

¹³ Kjo ishte gjithashtu një arsye e zakonshme e theksuar nga punonjësit në komunat ku u zhvilluan intervistat.

Gjilani së fundi kanë hapur pozita të reja për zyrtarë të diasporës, përshkrimet e punës së këtyre pozitave mbeten të paqarta. Kjo krijon vështirësi edhe për përzgjedhjen e stafit të duhur. Në të kundërt, komuna si Vushtrria dhe Kamenica kanë zhvilluar mandate më të qarta.¹⁴ Për shembull, përshkrimi i punës për zyrtarët e diasporës në Komunën e Kamenicës përcakton qartë përgjegjësitë kryesore të zyrtarit. Ata kërkojnë mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për bizneset e diasporës, organizimin e takimeve me organizatat e diasporës, koordinimin dhe organizimin e panairëve tregtare mes bizneseve lokale dhe atyre të diasporës, mbështetjen për bizneset e anëtarëve të diasporës që dëshirojnë të kthehen në Kosovë, dhe rekomandimin e politikave në nivel komunal që mbështesin interesat e komunitetit të diasporës.

Një faktor i rëndësishëm që krijon dallime në trajtimin e komunitetit të diasporës është larmia e profesioneve të zyrtarëve që angazhohen në këto çështje. Për shembull, disa komuna angazhojnë staf nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS), disa të tjerë nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE), dhe disa nga drejtori të tjera. Kjo krijon një qasje të paqëndrueshme, sepse zyrtarët që merren me aktivitete kulturore mund të mos kenë një pasqyrë të qartë për aspektet ekonomike të angazhimit me diasporën, dhe anasjelltas.

Megjithatë, ekziston dakordim mes zyrtarëve komunalë se është i nevojshëm të paktën një zyrtar/e i/e dedikuar me kohë të plotë për diasporën. Këtë e kanë mbështetur edhe zyrtarë të MPJD. Megjithatë, Komuna e Gjakovës ka vënë në dyshim nevojën për një rol të tillë, duke argumentuar se ai mund të dyfishojë funksionet ekzistuese komunale.

— 4.2. Ofrimi i shërbimeve

Shumica e shërbimeve për diasporën që ofrohen në nivel lokal mbeten të natyrës administrative, të përqendruara në dokumentet e gjendjes civile dhe regjistrimin e pronës. Këto shërbime, ndonëse të rëndësishme, ende nuk adresojnë potencialin më të gjerë për angazhim ekonomik ose bashkëpunim në zhvillim. Për shembull, Gjilani ofron një shërbim të përshpejtuar për regjistrimin e pronës, i cili përfundon brenda pesë ditëve¹⁵, dhe zbaton tarifa fikse të shërbimeve komunale për banorët e diasporës për të siguruar faturim të drejtë dhe më të thjeshtëzuar. Gjatë sezonit të verës, komunat në gjithë Kosovën zgjasin orarin e punës dhe hapin zyrat edhe të shtunave për të akomoduar anëtarët e diasporës që kthehen. Kamenica, në veçanti, ka krijuar dy sportele të dedikuara gjatë muajve të verës për të siguruar mbështetje të shpejtë dhe të përshtatur për diasporën.

Një pjesë e presionit mbi komunat për ofrimin e dokumentacionit të gjendjes civile është zbutur falë digjitalizimit të shërbimeve të regjistrimit civil. Ky përmirësim ka lehtësuar procesin e ofrimit të shërbimeve dhe ka zvogëluar ngarkesën mbi stafin administrativ gjatë periudhave të kthimit masiv të diasporës.

Megjithatë, intervistat e zhvilluara me Agjencinë e Regjistrimit Civil të Kosovës tregojnë se shumë anëtarë të diasporës vazhdojnë të udhëtojnë drejt Kosovës për të marrë dokumente që teknikisht mund t'i marrin përmes shërbimeve konsullore në vendet ku jetojnë dhe ose online. Kjo vjen si pasojë e mungesës së informimit dhe qasjes së kufizuar në kanalet konsullore. Të dhënat nga Agjencia e Regjistrimit Civil tregojnë se gjithsej 35,059 pasaporta dhe 15,792 letërnjoftime janë lëshuar përmes shërbimeve konsullore jashtë vendit në vitin 2024. Kërkesa më e lartë është shënuar në Gjermani, veçanërisht në Mynih,

¹⁴ [Vendimi për vendin e punës i publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit](#)

¹⁵ Megjithatë, nuk ka asnjë dokument ligjor që e rregullon këtë çështje. Siç thotë Zyrtari për Diasporën në Gjilan, kjo është më tepër një qëndrim politik brenda komunës sesa një rregullore specifike.

Shtutgart, Dyseldorf dhe Frankfurt, duke reflektuar diasporën e madhe kosovare atje. Zvicra ka regjistruar gjithashtu numër të lartë, sidomos në Cyrih, Gjenevë dhe Bernë. Konsullata të tjera aktive kanë qenë ato në Bruksel, Paris, Strasburg dhe Milano. Në të kundërt, konsullatat në vende si Ajova, Kanbera dhe Pragë kanë përpunuar shumë pak dokumente.

Disa komuna po fillojnë të eksplorojnë qasje më inovative. Gjilani, duke marrë shembullin e Pejës, ka propozuar ngritjen e pikave të informimit turistik për vizitorët nga diaspora. Ndërkohë, Kamenica ka zbatuar një platformë digjitale për monitorimin në kohë reale të bizneseve lokale, duke e ndihmuar komunën të përcjellë aktivitetin ekonomik dhe angazhimin, me interesin e diasporës për investime që është në rritje. Megjithatë, boshllëqe të gjera vazhdojnë të jenë të pranishme. Shumë komuna nuk kanë shërbime të dedikuara ekonomike për diasporën dhe pak prej tyre kanë mekanizma për të mbështetur partneritete të strukturuar mes shoqatave të diasporës dhe organizatave lokale të shoqërisë civile. Komuna si Lipjani, Prizreni dhe Gjilani kanë shprehur mbështetje të fortë për idenë e krijimit të skemave të dedikuara të financimit për të lehtësuar bashkëpunimin me nismat e udhëhequra nga diaspora. Në Obiliq, për shembull, anëtarët e diasporës mund të marrin këshillime të përshtatura për investime nga zyrtarët komunalë të zhvillimit ekonomik, të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e nismave lokale të investimit, ndërsa Vushtrria ka krijuar partneritete publike private ku investitorët nga diaspora mbështesin aktivitete kulturore në këmbim të qasjes sezonale në hapësirat komunale si tregjet dimërore.

— 4.3. Shkëmbimi arsimor dhe kulturor

Përveç shërbimeve administrative, disa komuna kanë ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me diasporën përmes shkëmbimeve arsimore, aktiviteteve kulturore dhe filantropisë. Lipjani ka ofruar një shembull të mirë në të kaluarën përmes programit të shkëmbimit shkollor, ku nxënësit kanë udhëtuar në Gjermani për një vizitë dyjavore arsimore, të financuar tërësisht nga diaspora. Po ashtu, Klubi Letrar i Lipjanit organizon rregullisht aktivitete me poetë nga diaspora, duke nxitur lidhje më të thella kulturore.

Komuna e Kamenicës ka zhvilluar lidhje veçanërisht të forta me diasporën e saj. Sipas Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës, shumë fshatra të komunës kanë shoqatat e tyre të diasporës, të cilat mbështesin në mënyrë aktive zhvillimin lokal. Këto shoqata financojnë rregullisht projekte në vendlindje, si renovimin e shkollave, furnizimin me pajisje arsimore dhe mbështetjen për familjet në nevojë. Diaspora e fshatit Busavatë, për shembull, ka udhëhequr nisma për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe qasjes në materiale mësimore. Takime të rregullta komunitare organizohen nga komuna për përfaqësuesit e diasporës dhe bizneset. Këto angazhime nuk janë aktivitete të rastit, por të integruara në proceset e planifikimit vjetor të komunës, veçanërisht gjatë verës. Komuna ka punuar gjithashtu në lehtësimin e investimeve, në vitin 2023, një pronë komunale iu dha me qira një investitori nga diaspora, i cili hapi një fabrikë për prodhimin e ambalazhit të aluminit që eksporton në Zvicër. Kamenica publikon çdo vit pasuritë e saj komunale të disponueshme në faqen e internetit për të tërhequr investime të tjera të ngjashme.¹⁶

Një vërejtje e rëndësishme e bërë nga zyrtarët e Lipjanit është se pa një strategji të qartë dhe angazhim të dyanshëm, nga komuna dhe nga institucionet qendrore, shoqatat e komunitetit të diasporës do të dobësohen dhe lidhja e diasporës me vendlindjen rrezikon të zbehet.

¹⁶ Lista e pronave të komunës, e disponueshme në : <https://kamenice.rks-gov.net/prokurimi/?tax=ankandet-publike>.

4.4. Potenciali ekonomik

Sipas intervistave me zyrtarët për diasporën në komuna, interesi i komuniteteve të diasporës për të investuar në Kosovë vazhdon të rritet, veçanërisht në sektorë si ndërtimtaria, bujqësia, gastronomia dhe prodhimi i vogël. Komunat kanë filluar të dokumentojnë këto shprehje interesi përmes bazave të brendshme të të dhënave për investime, megjithëse shumë prej tyre ende nuk kanë sisteme për të ndjekur në mënyrë efektive këto kërkesa. Komuna e Kamenicës e ka adresuar këtë boshllëk duke zhvilluar një profil të plotë ekonomik komunal, të dizajnuar për të mbështetur angazhimin me diasporën dhe nismat e qeverisë qendrore si diplomacia ekonomike. Kohët e fundit, komuna ka përgatitur edhe një dokument informues për investorët, një përmbledhje e mundësive lokale, infrastrukturës dhe kushteve rregullatore. Këto hapa gjithashtu adresojnë kërkesat e hershme nga Departamenti i Diplomacisë Ekonomike dhe Departamenti i Diasporës në Komunën e Kamenicës, duke pasqyruar një model të ri të promovimit të investimeve të bazuara në të dhëna.

Disa komuna organizojnë aktivitete të rregullta për të nxitur pjesëmarrjen e diasporës. Nga panairët e artizanatit dhe tregjet e produkteve vendore deri te festivalet kryesore si Ditët e Diasporës, festimet kulturore janë një pjesë e qëndrueshme e programeve verore. Në Ferizaj, këto përpjekje plotësohen nga një bazë të dhënash me 70 deri 80 biznese të udhëhequra nga diaspora, e cila përdoret për të organizuar aktivitete të rrjetëzimit të bizneseve dy herë në vit dhe për të nisur një nismë Business to Business, B2B. Në Gjilan, përpjekjet aktive për të tërhequr investorë kanë sjellë një bashkëpunim të rëndësishëm mes një kompanie shqiptare dhe një kompanie franceze, të cilat aktualisht operojnë në Parkun e Biznesit në Gjilan, një lokacion strategjik për investime. Në Vushtrri, bashkëpunimi me diasporën ka mundësuar binjakëzimin e qytetit me disa qytete evropiane, gjë që ka rezultuar në nisma të Investimeve të Huaja Direkte (IHD).

4.5. Sfidat e koordinimit mes institucioneve lokale dhe qendrore

Të gjithë pjesëmarrësit e grupit të fokusuar nga MPJD dhe komunat janë pajtuar se mungesa e një linje të drejtpërdrejtë komunikimi mes MPJD dhe një zyrtari/eje të dedikuar për diasporën pengon proceset dhe krijon më shumë burokraci. Kjo praktikë krijon boshllëqe në ofrimin e shërbimeve dhe dobëson qëndrueshmërinë dhe cilësinë e angazhimit me diasporën. Diskutimet treguan gjithashtu pengesa të rëndësishme strukturore, ligjore, financiare dhe operacionale. Komunat kanë theksuar se ndarja e fondeve për aktivitetet e diasporës është e pamjaftueshme dhe se koordinimi me MPJD shpesh është i dobët ose mbështetet në komunikim joformal. Në raste të tjera, si në Lipjan dhe Gjakovë, është vërejtur se nismat që lidhen me diasporën shpesh mungojnë në planifikim strategjik dhe ndonjëherë përsëriten mes nivelit qendror dhe atij lokal për shkak të ndarjes së paqartë të roleve. Mungesa e mekanizmave të përcaktuar qartë të koordinimit bën që komunat dhe ministria ndonjëherë të përsërisin përpjekjet ose të humbin mundësitë për veprim të përbashkët.

MPJD i ka pranuar këto sfida dhe ka theksuar se, ndonëse ministria promovon idenë që çdo komunë duhet të ketë një zyrtar/e të caktuar për diasporën, përgjegjësia për buxhetimin dhe planifikimin bie kryesisht mbi vetë komunat. Ministria ka zbatuar tashmë programe si bursat për kthimin e profesionistëve të kualifikuar nga jashtë dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa komuna për të mbështetur këto nisma. Sidoqoftë, përfaqësuesit e ministrisë kanë theksuar se angazhimi efektiv me diasporën varet në fund nga përfshirja aktive dhe iniciativa e zyrtarëve lokalë. Një çështje tjetër e rëndësishme e ngritur gjatë grupit të fokusuar ka qenë kapaciteti

dhe trajnimi i kufizuar i stafit komunal. Shumë zyrtarë nuk kanë përshkrime të qarta të detyrave për punën me diasporën dhe shpesh nuk kompensohen në mënyrë të mjaftueshme për përgjegjësitë shtesë. Për më tepër, mungesa e sistemeve qendrore të raportimit dhe një baze të përbashkët të të dhënave e vështirëson ndjekjen e nevojave dhe kontributeve të diasporës në mënyrë të strukturuar.¹⁷

Gjetjet nga diskutimet e grupit të fokusuar dhe intervistat individuale me komunat që janë pjesë e këtij vlerësimi tregojnë nevojën për ndërtimin e kapaciteteve në angazhimin me diasporën. Edhe pse disa komuna, si Vushtrria, Kamenica dhe Suhareka, kanë krijuar drejtoritë e dedikuara për diasporën dhe kanë treguar qasje proaktive, shumica e komunave nuk kanë infrastrukturë institucionale, qartësi ligjore, ose kapacitete të burimeve njerëzore për të zbatuar shërbime të qëndrueshme dhe strategjike për diasporën.

Grupi i fokusuar ka kërkuar gjithashtu koordinim më të fortë kombëtar për mbrojtjen e identitetit kulturor jashtë vendit. Është rekomanduar që mësimi i gjuhës shqipe të mbështetet përmes platformave online të qasshme, pasi shumë familje në diasporë hasin sfida në ruajtjen e gjuhës dhe lidhjeve kulturore në vendet ku jetojnë. Po ashtu, pjesëmarrësit kanë theksuar nevojën për shpërndarje më të mirë të informacionit praktik, si procedurat doganore, të cilat duhet të jenë të qasshme përmes një faqeje të vetme qendrore për të parandaluar keqinformimin ose praktikat diskriminuese.

Komunat kanë theksuar rëndësinë e tërheqjes së investimeve nga diaspora, veçanërisht përmes zhvillimit të zonave industriale. Ka pasur mendim të përbashkët se rolet komunale në angazhimin me diasporën nuk duhet të kufizohen në ofrimin e shërbimeve, por duhet të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe kthimin e profesionistëve të kualifikuar. Megjithatë, pjesëmarrësit kanë përsëritur se autoritetet lokale nuk kanë burime të mjaftueshme financiare për t'i zbatuar këto synime pa mbështetje më të fortë buxhetore dhe bashkëpunim nga ministria.

Për më tepër, intervistat kanë theksuar nevojën për të integruar qasje të ndjeshme ndaj gjinisë brenda programeve për diasporën për të siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse. Gratë shpesh nuk përfshihen në diskutimet publike dhe perspektiva e tyre shpesh anashkalohet. Një qasje e ndjeshme ndaj grave të diasporës nënkupton adresimin aktiv të barrierave si qasja e kufizuar në mundësi ekonomike, shërbime shoqërore dhe platforma vendimmarrëse, si në vendet pritëse ashtu edhe pas kthimit.

¹⁷ Zyrtari për diasporën nga Komuna e Suharekës theksoi pasojat e bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë për Diasporën në një ministri të vetme. Ai solli shembullin e ministrive të tjera, si Ministria e Arsimit, ku Drejtoria e Arsimit raporton dhe është në bashkëpunim të ngushtë me nivelin qendror..

5. Hartëzimi digjital

Në rastin e Kosovës, ku diaspora luan rol të rëndësishëm në zhvillimin shoqëror, kulturor dhe ekonomik, platformat digjitale ofrojnë mundësi për komunikim të strukturuar, lehtësim të investimeve dhe shkëmbim kulturor. Sipas të dhënave të mbledhura përmes intervistave dhe grupit të fokusuar, infrastrukturës digjitale për angazhimin me diasporën në Kosovë i mungon koherenca. Ndërsa ekzistojnë platforma që adresojnë nevoja specifike, administrative, kulturore ose ekonomike, nuk ka një strategji të unifikuar që i konsolidon këto shërbime. Mungesa e ndërveprimit mes platformave ul efikasitetin e komunikimit dhe kufizon potencialin për integrimin e diasporës. Për më tepër, sistemet aktuale nuk shfrytëzojnë analizat digjitale për të kuptuar demografinë e diasporës, trendet e angazhimit, ose sjelljen investuese, gjë që kufizon hartimin e politikave të bazuara në të dhëna.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), ka udhëhequr disa nisma për të forcuar marrëdhëniet me diasporën përmes zgjidhjeve digjitale si Shijo Kosovën, Ulpiana Forum dhe Made in Kosova. Përveç kësaj, MPJD synon të zhvillojë platformën e-Diaspora, një version i hershëm i së cilës është përdorur vetëm për regjistrimin e diasporës së Kosovës gjatë regjistrimit të popullsisë. Platforma është konceptuar si një mjet qendror për hartëzimin e organizatave dhe planifikimin e angazhimit. Sipas përfaqësuesve të MPJD, projekti po koordinohet në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendësministrit të MPJD dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, ASHI, e cila do të mbikëqyrë zbatimin teknik. Një koncept dokument është nisur në vitin 2024 dhe MPJD ka ndarë një buxhet prej 15,000 euro për zhvillimin e platformës për gjysmën e dytë të vitit 2025. Për të ecur përpara, MPJD duhet të kontrakttojë një zhvillues ose organizatë për implementimin e platformës. Karakteristikat kryesore të parashikuara përfshijnë profile të detajuara të komunave, një bazë të dhënash të organizatave të diasporës dhe planifikim strategjik. Platforma synon të përmirësojë koordinimin, dukshmërinë dhe mbështetjen për nismat e diasporës, duke kontribuar në një komunitet të diasporës së Kosovës më të lidhur dhe më të informuar.

Megjithatë, disa platforma të menaxhuara nga institucione të ndryshme u ofrojnë shërbime të caktuara anëtarëve të diasporës së Kosovës. Për shembull, e-Kosova ofron shërbime administrative si lëshimi i dokumenteve dhe caktimi i takimeve për apostille për qytetarët jashtë vendit. Po ashtu, Made in Kosova dhe KIESA adresojnë interesat ekonomike duke ofruar informacione mbi procedurat e investimeve, lehtësitë fiskale dhe mundësitë specifike për sektorë të ndryshëm. Platforma të tjera si Shijo Kosovën dhe Ulpiana Forum fokusohen në diplomacinë kulturore dhe angazhimin e të rinjve, duke ofruar hapësira për aktivitete, trajnime dhe bashkëpunim të shoqërisë civile. Megjithatë, funksionaliteti dhe përmbajtja e këtyre platformave ndryshon ndjeshëm. Disa, si Made in Kosova, ofrojnë vetëm informacione sipërfaqësore, duke treguar mungesë të përditësimit të rregullt dhe menaxhimit strategjik të përmbajtjes. Për më tepër, këto platforma funksionojnë në mënyrë të pavarur, duke rezultuar në fragmentim dhe jo në një përvojë të integruar digjitale.

Përveç mungesës së ndërveprimit mes platformave ekzistuese, përmes këtij hartëzimi janë identifikuar disa probleme të tjera. Shumica e platformave funksionojnë si depo statike të informacionit, në vend që të jenë mjete interaktive që mundësojnë komunikim në kohë reale, komente ose rrjetëzim. Ato nuk ofrojnë informacione ose përditësime të rëndësishme që do të nxisnin angazhim ekonomik dhe kulturor të diasporës. Këto platforma janë të disponueshme vetëm në gjuhët zyrtare në Kosovë, shqip dhe serbisht.

5.1. Kanalet e komunikimit të komunave

Të tridhjetë e tetë komunat e Kosovës mbajnë një prezencë online kryesisht përmes faqeve zyrtare në Facebook, të cilat janë bërë mjete kryesor i komunikimit për ndarjen e lajmeve lokale, njoftimeve publike dhe informacioneve për aktivitete. Ndërsa këto kanale janë efektive për angazhimin e banorëve brenda komunës, rëndësia e tyre për diasporën mbetet e kufizuar. Përmbajtja rrallë u drejtohet posaçërisht komuniteteve të diasporës, si përditësime për mundësi investimi, informacione mbi pronat ose aktivitete kulturore jashtë vendit. Në vend të kësaj, postimet fokusohen kryesisht në çështje administrative lokale ose ngjarje komunitare, të cilat mund të mos përputhen me interesat e kosovarëve që jetojnë jashtë.

Përveç faqeve zyrtare, ekzistojnë shumë grupe joformale në Facebook të krijuara nga vetë komunitetet në diasporë. Këto grupe funksionojnë shpesh si rrjete të vetë-organizuara, ku anëtarët e diasporës shkëmbejnë informacione mbi zhvillimet në vendlindje, fushata të mbledhjes së fondeve dhe aktivitete kulturore. Megjithatë, këto grupe operojnë të pavarura nga administratat komunale, gjë që sjell mungesë përfaqësimi dhe koordinimi zyrtar. Ky hendek tregon një mundësi për komunat që të krijojnë strategji të strukturuar të angazhimit digjital, duke integruar komunikimin zyrtar me rrjetet ekzistuese të komunitetit dhe duke shfrytëzuar mediat sociale për të shpërndarë përmbajtje të orientuar drejt diasporës.

Disa komuna kanë nënshkruar tashmë kontrata për të angazhuar portalet lokale të lajmeve për qëllime informimi. Këto marrëveshje parashehin që të gjitha informacionet e rëndësishme për zhvillimet në komuna të bëhen publike dhe të sigurohet një shtrirje më e gjerë. Sipas zyrtarëve lokalë, kjo ka rezultuar një strategji efektive, pasi portalet lokale të lajmeve kanë ndjekës nga komuniteti i diasporës specifik për secilën komunë.

6. Përfundimi dhe rekomandimet

Instituti GAP rekomandon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për forcimin e angazhimit të diasporës në Kosovë, me veprime të nevojshme në strukturat komunale, institucionet kombëtare dhe platformat digjitale.

- Komunat duhet të krijojnë pozita të dedikuara për zyrtarë të diasporës me mandate të qarta, të mbështetura nga rregulloret e rishikuara të Ministrisë së Financave që lejojnë krijimin dhe financimin fleksibil të këtyre roleve. Kapacitetet e stafit duhet të forcohen përmes trajnimeve të vazhdueshme ligjore, digjitale, të planifikimit dhe qasjeve të ndjeshme ndaj gjinisë, si dhe përmes bashkëpunimit ndërmjet drejtorive.
- Shërbimet për diasporën duhet të institucionalizohen gjatë gjithë vitit, duke u tejkaluar mbështetja sezonale dhe të zgjerohet gama e tyre nga detyrat administrative drejt lehtësimit të investimeve, promovimit të turizmit dhe angazhimit të bizneseve.
- Komunat duhet të zhvillojnë strategji afatgjata për angazhimin e diasporës, të harmonizuara me kuadrot kombëtare, të krijojnë struktura të përhershme dialogu, si këshillat ose forumet e diasporës, dhe të përmirësojnë koordinimin me MPJD përmes grupeve të përbashkëta të punës dhe platformave të përbashkëta të planifikimit.
- Komunat duhet të rrisin dukshmërinë e mundësive të investimit përmes portaleve online, paketave për investitorë, hartave interaktive dhe këndeve të diasporës të lidhura me një platformë kombëtare. Duhet të krijohet gjithashtu një bazë e dhënash qendrore kombëtare për diasporën, e cila t'u vihet në dispozicion komunave për koordinim dhe ofrim të shërbimeve.
- Shqoqatat e diasporës në nivel lokal duhet të inkurajohen dhe të integrohen në përpjekjet e zhvillimit, ndërsa partneritetet ndërkombëtare dhe nismat e binjakëzimit të qyteteve duhet të zgjerojnë rrjetet e diasporës dhe të tërheqin investime të huaja direkte (IHD).
- Po ashtu, duhet të riaktivizohet Kolegjiumi për Diasporën në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) si mekanizëm funksional i bashkëpunimit ndërkomunal, duke mundësuar që zyrtarët komunalë për diasporën të shkëmbejnë praktika të mira, të harmonizojnë qasjet institucionale dhe të kontribuojnë në koordinimin horizontal mes komunave, me qëllim rritjen e përfshirjes së diasporës në nivelin lokal.
- Skemat komunale të granteve duhet të mbështesin nisma të përbashkëta diasporë-organizata të shoqërisë civile, duke përfshirë programe për të rinjtë dhe gratë në udhëheqje, arsim dhe sipërmarrje. Nismat për kthimin e trurit duhet të ofrojnë bursa, praktika dhe lidhje të aftësive për profesionistët që kthehen, duke integruar qasje të ndjeshme ndaj gjinisë në të gjitha politikat dhe programet për të siguruar mbështetje të synuar për gratë e diasporës që kthehen.
- Një sistem i unifikuar dhe i lehtë për përdorim duhet të integrojë shërbimet kombëtare me komunikimin komunal. Platforma e-Diaspora duhet të shërbejë si porta kryesore që lidh platforma si e-Kosova, KIESA dhe faqet digjitale të komunave, e mbështetur nga qasja përmes një identifikimi të vetëm (SSO), për të hyrë në shërbime që variojnë nga kërkesat për dokumente të informacionet për investime dhe regjistrimi i aktiviteteve.
- Për të siguruar koherencë, komunat duhet të ndjekin udhëzime të unifikuara të përmbajtjes dhe të sigurojnë materiale dygjuhësore, shqip dhe anglisht, dhe ku është e nevojshme, serbisht, gjermanisht ose turqisht. Platforma duhet të integrojë faqet e rrjeteve sociale të komunave përmes publikimeve të automatizuara dhe të formalizojë lidhjet me grupet joformale të diasporës në Facebook.

Aneksi

Tabela 1. Shërbimet dhe strukturat komunale për diasporën

Komuna	Zyrtar me kohë të plotë për diasporën?	Drejtori për diasporën?	Bazë të dhënash të bizneseve të diasporës?	Orar të zgjatur / sportele verore?	Mekanizëm informimi / njoftimi për diasporën?	Regjistrim i përsheptuar i pronës?
Gjilan	Po	Po	Po	Po	Po	Pa informata
Vushtrri	Po	Po	Po	Po (dy sportele verore)	Po	Pa informata
Kamenica	Po	Sektor për diasporën	Po	Po	Po	Jo
Suharekë	Jo (vetëm me orar të pjesshëm)	Jo	Po	Po	Po	Jo
Lipjan	Jo (vetëm me orar të pjesshëm)	Jo	Po	Po	Po	Jo
Ferizaj	Jo	Jo	Po	Po	Po	Jo
Prizren	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Jo
Podujevë	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Jo
Obiliq	Jo	Jo	Pa informata	Pa informata	Po	Jo
Dragash	Jo	Jo	Jo	Po	Po	Jo

(Burimi: nga intervistat me palët e interesit)

Tabela 2. Platformat digjitale të lidhura me Kosovën dhe angazhimin e diasporës

Nr.	Platforma	Përshkrimi	Pronësia	Shërbime të lidhura me diasporën
1	e-Kosova https://ekosova.rks-gov.net/	Platformë për ofrimin e shërbimeve administrative, kryesisht për marrjen e dokumenteve zyrtare.	Ministria e Punëve të Brendshme	Platforma tani përfshin shërbimin e caktimit të terminit për certifikimin me apostille.
2	Made in Kosova https://made-in-kosova.net/	Platformë me informata ekonomike.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, MPJD	Ofron informata të përgjithshme për investime në Kosovë, përfshirë: ligjet për regjistrim biznesi, udhëzime për procedurat e hapjes së biznesit, lehtësitë fiskale, kërkesat e licencimit dhe të dhëna për zonat ekonomike. <i>Shënim: platforma ka nevojë për përditësim, pasi ofron informata bazike.</i>

3	e-Diaspora	Platformë digjitale në zhvillim, e synuar për regjistrimin e diasporës gjatë ReKos dhe për angazhim të ardhshëm.	MPJD	Është përdorur për regjistrimin dhe hartëzimin e diasporës gjatë regjistrimit të popullsisë.
4	KIESA https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,110	Platformë për mbështetjen e investimeve dhe eksporteve nga dhe në Kosovë.	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, MINT	Sa i përket zhvillimit lokal dhe angazhimit të diasporës në investime, ofron informacione themelore për mundësitë e të bërit biznes në Kosovë dhe informacion të detajuar për mundësitë e investimit në 14 komuna.
5	Platforma Digjitale https://www.platformadigjitale.com/	Platformë digjitale për pjesëmarrje publike, që mundëson komunikim interaktiv dhe transparent mes qytetarëve dhe komunave.	OSBE (donator)	Lejon qytetarët, përfshirë diasporën, të dërgojnë propozime, të regjistrojnë ide ose rekomandime për lagjen ose komunën, si dhe të paraqesin ankesa për shërbimet komunale. Zyrtarët komunalë përgjigjen drejtpërdrejt.
6	Diaspora Investment Window https://fondikgk.org/dritarja-diaspores/	Platformë e dedikuar për investitorët e diasporës, që lehtëson mbështetjen financiare përmes instrumenteve bankare.	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)	Investitorët e diasporës që duan të themelojnë ose bashkëinvestojnë në biznese të reja (jo më të vjetra se 36 muaj) mund të marrin kredi të garantuara deri në 80%, deri në 3 milionë euro, me afat kthimi deri në 84 muaj. Kriteret: origjinë kosovare, më shumë se 3 vjet banim jashtë vendit. Aplikimi bëhet përmes bankave komerciale.
7	Oda Ekonomike e Kosovës https://www.oek-kcc.org/	Oda me anëtarësi për bizneset vendore dhe të huaja që operojnë në Kosovë.	Oda Ekonomike e Kosovës	Ofron mbështetje administrative dhe operacionale për bizneset, informacione për investime, rrjetëzim B2B, organizim ngjarjesh dhe qasje në bazën e ekspertëve gjermanë të pensionuar për mbështetje të përballueshme të zhvillimit të bizneseve.

Tabela 3. Platformat e lidhura me aktivitetet kulturore dhe diplomatike

Nr.	Platforma	Përshkrimi	Pronësia	Shërbime të lidhura me diasporën
1	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) https://www.mkrs-ks.org/?page=1,114	Siguron financim publik për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.	MKRS	Hap thirrje vjetore për financim për komunitetet e diasporës, për individë dhe OJQ, me qëllim angazhimin e diasporës në fusha si kultura, rinia dhe sporti.
2	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) https://mfa-ks.net/shpallje-dhe-vendime/	Ofron financim publik për aktivitete që lidhen me diasporën.	MPJD	Hap tre thirrje vjetore deri në 900 mijë euro në mbështetje të aktiviteteve të diasporës. Vetëm OJQ-të mund të aplikojnë me projekte deri në një vit.
3	Shijo Kosovën https://shijokosoven.com/	Platformë informative për aktivitetet e diasporës të organizuara nga MPJD dhe shoqëria civile.	MPJD	Ofron informacione për nisma rinore dhe kulturore të financuara nga MPJD, promovon ngjarje kulturore dhe liston aktivitete për diasporën në bashkëpunim me disa komuna.
4	Ulpiana Forum https://ulpianaforum.org/	Forum që shfrytëzon kapacitetet diplomatike dhe zhvillimore të partnerëve për të forcuar angazhimin me diasporën.	MPJD	Shërben si platformë me shumë aktorë që nxit dialogun për ndikimin e diasporës dhe forcon partneritetet në këtë fushë.
5	Programi për Diplomaci Qytetare (CDF) https://cdfellowship.com/	Nismë që sjell së bashku profesionistë të rinj nga diaspora për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës.	MPJD	Ka hapur thirrje për bursë nga gushti 2024 deri në qershor 2025, duke angazhuar bursistë në MPJD dhe ministri të tjera të qeverisë së Kosovës.
6	GIZ https://diaspora2030.de/en/partner-countries/kosovo	Mbështet ekspertë të diasporës, organizata dhe sipërmarrës në 14 vende partnere. Kosova është njërën prej tyre.	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, BMZ	Ndihmon anëtarët e diasporës në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në vendlindje.
7	Platforma e Angazhimit të Profesionistëve të Diasporës (EDP) https://diasporaprofessionals.germin.org/#	Lehtëson lidhjen e profesionistëve të diasporës me institucione, organizata dhe biznese në Kosovë.	GERMIN	Hap thirrje për të sjellë njohuri dhe aftësi në Kosovë dhe Shqipëri, duke mundësuar transferim të ekspertizës aty ku nevojitet më shumë.




Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mesqeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org





**Fuqizimi i kapaciteteve
të komunave për angazhimin
e diasporës në Kosovë**